

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 20
02.10.2014

NR. VENDIMI 19
07.10.2014

V E N D I M

«Për Zgjatjen e Afatit të Zbatimit të Masës së Sekuestrimit të Pasurisë»

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

GJYQTARE: Liljana BAKU

Asistuar nga sekretare séance **Olta SINANAJ**, sot në datë 07.10.2014, ora 09.30, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr.20 Regj. me:

KËRKUESE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Edvin KONDILI**.

KUNDËR SHTETASVE:

S.G., i biri i M. dhe i Sh., i datëlindjes xxx,
lindur dhe banues në xxx, xxx.

M.G., i biri i S. dhe i F., i datëlindjes xxx,
lindur dhe banues në xxx, xxx.

R.G., i biri i S. dhe i F., i datëlindjes xxx,
lindur dhe banues në xxx, xxx.

OBJEKTI:

I. Zgjatja e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit mbi pasuritë e shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., vendosur me Vendimin Nr.xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 3, 7, 11, 12, 14, 15 e vijues të Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për

parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të gjykimit, gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 12 pika 3 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoi diskutimin përfundimtar të prokurorit, në të cilin ai kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë xxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xx Viti xxx, në ngarkim të shtetasve nën hetim M.G., S.G. dhe R.G., si persona të dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimi pasuror ishte rrjedhojë e procedimit penal Nr.xx, Viti xxx, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Nga materiali hetimor, që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx i dërgoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, rezultoi sa më poshtë:

Shtetasi M.G. në datë xxx depozitoi në Bankën xxx në llogarinë rrjedhëse me Nr. xxx, shumën prej xxx (xxx) euro, në datë xxx shumën prej xxx (xxx) euro, në datë xxx shumën prej xxx (xxx) euro, të deklaruara prej tij si përfitime nga emigracioni dhe, po në datë xxx shumën prej xxx (xxx) euro të deklaruar si shumë e marrë hua nga shtetasi V.B.

Shtetasit R.G. dhe S.G., në datë xxx çelën në Bankën xxx llogarinë bankare me Nr. xxx duke depozituar në të shumën prej xxx (xxx) dhe deklaruar si burim të saj emigracionin.

Në datë xxx, shtetasi M.G. transferoi shumën monetare prej xxx (xxx) euro, nga llogaria e tij në llogarinë bankare të shtetasës R.R., me profesion notere (anëtare e Dhomës së Noterisë xxx), në funksion të përmbylljes së kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të lidhur prej tij me palë shitëse shtetasin J.S.. Aktualisht shuma monetare, prej xxx euro, ndodhet në Bankën xxx, në llogarinë e shtetasës R.R..

Gjithashtu, pranë Bankës xxx, u konstatuan një shumë prej xxx (xxx) euro në emër të M.G., në llogarinë me numër xxx dhe, një shumë prej xxx (xxx) euro në

emër të shtetasve R. dhe S.G., në llogarinë me numër xxx (e cila, siç do të rezultojë më poshtë, mbeti pas transferimit prej shumës xxx euro të shumës prej xxx euro, në funksion të plotësimit të shumës prej xxx euro).

Për llogaritë bankare të mësipërme, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx kishte vendosur masën e sekuestros preventive.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me Vendimin Nr.x datë xxx, vendosi masën e sekuestros mbi shumat monetare të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., të përbërë prej: **1. Shumës xxx (xxx) xxx euro**, që ndodhen në bankën xxx, në llogarinë e shtetasës R.R. e datëlindjes xxx. **2. Shumës xxx (xxx euro**, në emër të M.G., në llogarinë me numër xxx, në bankën xxx dhe **3. Shumës xxx (xxx) euro**, në emër të shtetasve R.G. dhe S.G., në llogarinë me numër xxx, në Bankën xxx.

Në vendim u vlerësua e provuar se shtetasit M.G., S.G. dhe R.G., bazuar në nenin 3 pika 1 gërma “d” të Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ishin subjekte të zbatimit të tij pasi ishin persona të dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, e parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal. Në këtë kuadër, gjykata arsyetoi se: Çelja e llogarive bankare në emër të tyre, në shuma të konsiderueshme eurosh dhe brenda një kohe shumë të shkurtër; Deklarimi, prej tyre, i shumave të depozituara si të ardhura nga emigracioni; Mungesa e ndonjë aktiviteti tregëtar, të regjistruar në emër të tyre apo familjarëve; Mungesa e pasurive të palujtëshme nga të cilat të mund të gjenerohen të ardhura; Mungesa e deklaramit për para kesh në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe mungesa e dërgesave të parave nëpërmjet unioneve të licensuar për këtë qëllim; përbënin indicje të rëndësishme, mbi bazën e të cilave ngrihej dyshimi për kryerje, nga shtetasit M.G., S.G. dhe R.G., të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, vepër kjo e përfshirë në rrethin e veprave penale për të cilat bën fjalë pika 1 e ligjit.

Shtetasit M.G., S.G., R.G. dhe familjarët e tyre nuk kishin të regjistruar asnjë aktivitet tregtar dhe asnjë të ardhur tjetër të ligjshme që të mund të justifikonin shumat e mëdha të eurove, të derdhura në llogari bankare.

Ekzistonte rreziku real për tjetërsimin e llogarive bankare. Duke qënë se masa e sekuestros preventive ishte e kushtëzuar nga ecuria e procedimit penal, në rast pushimi të tij, ishte e natyrshme që shtetasit M.G., S.G. dhe R.G. të bënin të gjitha përpjekjet për t’i mbyllur ato me qëllim shmangien nga një konfiskim i

mundshëm.

Në datë xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë depozitoi, në sekretarinë e gjykatës, kërkesën për zgjatjen e afatit të sekuestros, mbi pasurinë e shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., për një muaj.

Në kërkesën e paraqitur, prokurori pretendoi se masa e sekuestros, me afat gjashtëmuajor, e vendosur me Vendimin Nr.xx datë xxx, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, u ekzekutua në datë xxx, duke qënë e vlefshme deri në datë xxx. Fakti i ekzekutimit të saj dokumentohej me Shkresën Nr.xxx Prot. datë xxx të Bankës xxx.

Në vazhdim të verifikimeve të kryera, sipas prokurorit, u administrua vendimi i pushimit të hetimeve për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, në ngarkim të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., disponuar nga Prokuroria pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor xxx. Ky vendim, sipas tij, bazuar në nenet 3 dhe 24 të Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, passillte përjashtimin e këtyre shtetasve nga qënia subjekt i verifikimeve pasurore.

Organi procedues, pavarësisht pasojës së pretenduar sa më sipër, e shikonte të nevojshme marrjen e një informacioni shtesë, nga policia gjyqësore, për shtetasit M., S. dhe R.G., nëse kishte të dhëna të tjera për përfshirje në aktivitet kriminal, nga ato të parashikuara në fushën e zbatimit të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009. Në këtë rast, organi procedues mbajti parasysh operacionin policor, të organizuar në xxx xxx, në fshatin xxx xxx. Pikërisht, për marrjen e këtij informacioni, kërkohet zgjatja e afatit të masës së sekuestrimit për një muaj.

Gjykata, në analizë të pretendimeve dhe provave të paraqitura, çmon se kërkesa e paraqitur duhet të pranohet:

Nga përmbajtja e Shkresës Nr.xxx Prot. datë xxx të Bankës xxx rezultoi se masa e sekuestrimit, vendosur mbi pasurinë e shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., me Vendimin Nr.xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, u ekzekutua në datë xxx. Sipas parashikimit në nenin 12 pika 2 të Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009, masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmuajore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj. Pra ligjvënësi llogaritjen e afatit gjashtëmuajor e lidh me momentin e vënies në ekzekutim dhe jo me momentin e vendosjes së saj me vendim gjyqësor. Duke ju referuar momentit të ekzekutimit, afati gjashtëmuajor i sekuestrimit, sikurse paarshtroi prokurori, përfundon në datë xxx.

Prokurori, duke paraqitur kërkesën për zgjatje të afatit të sekuestrimit, në datë xxx, përmbushi detyrimin ligjor të parashikuar në pikën 5 të nenit 12 të Ligjit, sipas të cilës: *“Prokurori, jo më vonë se pesë ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit...mund të paraqesë kërkesë për konfiskimin e pasurisë ose zgjatjen e afatit të masës së sekuestros...”*.

Prokurori pretendoi nevojën e kryerjes së verifikimeve për aktivitet kriminal të mundshëm të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G. pasi, sipas tij, pas pushimit të hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, tre shtetasit nuk janë më subjekte të zbatimit të Ligjit Nr.10 192 datë 03.12.2009. Mbi këtë pretendim, ai kërkoi dhe zgjatjen e afatit të sekuestrimit. Për të provuar pretendimin prokurori paraqiti si provë Vendimin «Për pushimin e çështjes», datë xxx, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, ku rezultoi se pushimi i çështjes, bazuar në nenin 328 pika 1 gërma “b” të Kodit të Procedurës Penale, ishte vendosur pasi fakti nuk parashikohej si vepër penale.

Për gjykatën, pretendimi i prokurorit se shtetasit M., S. dhe R.G. nuk janë më subjekte të procedimit pasuror për shkak se çështja penale në ngarkim të tyre u pushua, nuk qëndron. Bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.10 192 datë 03.12.2009, procedura e caktimit dhe zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është e pavarur nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave subjekte të ligjit. Në momentin që gjykata konkludoi se shtetasit e lartpërmendur ishin subjekte të zbatimit të ligjit nuk u mjaftua thjesht tek fakti i regjistrimit të procedimit penal në organin e prokurorisë, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, por analizoi një sërë indicjesh që provonin ekzistencën e dyshimit për kryerjen prej tyre të kësaj vepre.

Pavarësisht se gjykata ka mendim ndryshe nga prokurori për sa i përket lidhjes që ekziston midis procedimeve penale dhe pasurore, ajo çmon se kërkesa për zgjatjen e afatit të sekuestrimit duhet të pranohet për t’i dhënë mundësi organit procedues të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme.

Në ndryshim nga prokurori, i cili kërkoi zgjatjen e afatit për një muaj, në kushtet kur në Ligj, në nenin 12 pika 3 e tij, parashikohen periudha zgjatje tremujore, për gjykatën zgjatja duhet të jetë tre muaj.

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, ekziston detyrimi ligjor që vendimi për zgjatjen e afatit të sekuestros t’i njoftohet zotëruesit të pasurive të sekuestruara. Në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132

dhe 133 të Kodit të Proçedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën për zgjatjen e afatit të sekuestrimit të drejtë, vendimi i saj duhet t'i njoftohet shtetasve nën hetim M.G., S.G. dhe R.G.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 12 pika 3 dhe 5, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

V E N D O S

Pranimin e kërkesës.

Zgjatjen e afatit, për një periudhë tremujore, të masës së sekuestrimit, vendosur me Vendimin Nr.xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, mbi shumat monetare të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., të përbërë prej: **1. Shumës xxx (xxx) xxx euro**, që ndodhen në Bankën xxx, në llogarinë e shtetasës R.R., e datëlindjes xxx. **2. Shumës xxx (xxx) euro**, në emër të M.G., në llogarinë me numër xxx, në Bankën xxx. **3. Shumës xxx (xxx) euro**, në emër të shtetasve R.G. dhe S.G., në llogarinë me numër xxx, në Bankën xxx.

Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t'u njoftojë shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor xxx dhe Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë, vendimin për zgjatjen e afatit të masë së sekuestrimit.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, në datë 07.10.2014.

SEKRETARE

Olta SINANAJ

GJYQTARE

Liljana BAKU